

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2934/3 Prot.

Tiranë, më 29 . 09 .2023

VENDIM QARKULLUES

Nr. 60 , datë 29.09 .2023

“PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË PLANIN VJETOR TË PUNËS, I NDRYSHUAR, PËR PERIUDHËN TETOR-DHJETOR 2023, TË NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”

Bazuar në nenin nr. 116 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; në nenin 53 të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë; në nenin 43 të Rregullores së UMT-së; në Rregulloren e Bordit të Administrimit; në ligjin nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, i ndryshuar; në Vendimin e BA-së, nr. 59, datë 19.10.2022 “Për miratimin e planit strategjik dhe vjetor 2023-2025, të veprimtarisë së Njesisë së Auditimit të Brendshëm, në UMT”; në Vendimin e BA-së nr. 40, datë 09.05.2023 “Për miratimin e ndryshimeve në planin e punës për vitin 2023, të Njesisë së Auditimit të Brendshëm, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”; si dhe në shkresat nr. 2493 prot., datë 10.08.2023 dhe nr. 2780/9 prot., datë 26.09.2023 të NJAB në UMT, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimet në Planin Vjetor të Punës, të ndryshuar, sipas kërkesës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për periudhën tetor-dhjetor 2023.
2. Ngarkohet Njësia e Auditimit të Brendshëm, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
ZAMIRA GJINI



MONIKA FIDA

ALBANA GJINOPULLI

ANËTARË
VERA OSTRENI

ANIS THODHORJANI

ALTINA XHAFERI

ENDRIT YZEIRAJ

Konceptoi: A. Golloshi [Signature] 28.09.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
REKTORATI
NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. 2780/10 Prot.

Tiranë, më 29/09/2023

MIRATOHET

KRYETAR

ZAMIRA GJINI



**PLANI VJETOR I PUNËS I NJËSISË SË
AUDITIMIT TË BRENDSHËM
PËR PERIUdhËN TETOR – DHJETOR 2023, I
NDRYSHUAR**

Nr	SUBJEKTI QË DO AUDITOHET	FUSHA QË DO TË AUDITOHET	VLERËSIMI IRRISKUT PËR FUSHËN	PERIUDHA QË DO TË AUDITOHET	PERIUDHA PËR AUDITIM	GRUPI I AUDITIMIT	TË TJERA
1	Fakulteti i Shkencave Mjekës. Teknike (FSHMT)	Sistemi i Sekretarisë mësimore	I mesëm	Janar-Tetor 2023	09.10.2023-17.11.2023	Majlind Shkira Rasim Metallari	
2	Fakulteti i Mjekësisë Dentare (FMD)	Sistemi i Sekretarisë mësimore	I mesëm	Janar-Nëntor 2023	30.11.2023-22.12.2023	Rasim Metallari Majlind Shkira	

P/ Njësisë së Auditimit të Brendshëm

Rasim METALLARI

